



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PER MEDIA

Ditën e hënë, në datë 26.10.2015, ora 12.00 u zhvillua mbledhja e radhës e Këshillit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, në prani të anëtarëve:

Z.Gentian Sala Kryetar

Z.Gledis Gjipali Anëtar

Z.Piro Misha Anëtar

Z.Zylyftar Bregu Anëtar

Këshilli i AMA-s, në përputhje me çështjet e rendit të ditës miratoi vendimet e mëposhtme:

1. Rrëzimin e kërkesës së paraqitur nga shoqëria “Aldo 03” sh.p.k., për subjektin radiofonik privat vendor “Aldo 03”;
2. Zëvendësimin e licencës së subjektit person fizik Adriatik Bajrami, me autorizim për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv kabllor Delvina”;

Këshilli gjithashtu mori në shqyrtim ankimet administrative ndaj sanksioneve më gjobë të vendosura ndaj subjekteve audio/audiovizivë, duke vendosur:

3. Pranimin e ankimit administrativ të shoqërisë “Nisatel” sh.p.k., duke shfuqizuar sanksionin gjobë nr. 36, datë 16.09.2015 të vendosur nga Grupi i Inspektorëve, në masën 5,000,000 (pesëmilion) lekë;
4. Pranimin e ankimit administrativ të subjektit Armand Baze, duke shfuqizuar sanksionin gjobë nr. 38, datë 17.09.2015 të vendosur nga Grupi i Inspektorëve, në masën 5,000,000 (pesëmilion) lekë, për subjektin audio privat vendor të palicencuar “Radio ABC”;
5. Pranimin e ankimit administrativ të subjektit Spiro Zguri, duke shfuqizuar sanksionin gjobë nr. 37, datë 17.09.2015 të vendosur nga Grupi i Inspektorëve, në masën 5,000,000 (pesëmilion) lekë, për subjektin audio privat vendor të palicencuar “Radio Magic Star”;
6. Pranimin e pjesëshëm të ankimit administrativ të shoqërisë “Fibernet” sh.p.k., duke ndryshuar masën e sanksionit me gjobë nr. 29, datë 01.09.2015 të vendosur nga Grupi i Inspektimit nga 10,000,000 (dhjetëmilion) lekë në 5,000,000 (pesëmilion) lekë, për instalimin e pajisjeve me anë të të cilave ofron shërbime audiovizive pa autorizimin e AMAs;
7. Rrëzimin e ankimit administrativ të shoqërisë “INTEL-MEDIA” sh.p.k., duke lënë në fuqi sanksionin gjobë nr. 39, datë 21.09.2015 të vendosur nga Grupi i Inspektorëve, në masën 5,000,000 (pesëmilionë) lekë, për subjektin audioviziv privat “Tv kabllor Jug”;
8. Pranimin e ankimit administrativ të shoqërisë “F.K.T” sh.p.k., duke shfuqizuar sanksionin gjobë nr. 27, datë 13.08.2015 të vendosur nga Grupi i Inspektorëve, në masën 3,000,000 (tremilionë) lekë, për subjektin audioviziv privat “Tv Apollon”;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

9. Rrëzimin e ankimit administrativ të subjektit person fizik Krenar Avdulla duke lënë në fuqi sanksionin gjobë nr. 17, datë 24.06.2015 të vendosur nga Grupi i Inspektimit, në masën 1,000,000 (një milion) lekë, për subjektin kabllor “TV Saranda Kabëll”;
10. Pranimin e ankimit administrativ të subjektit person fizik Krenar Avdulla duke shfuqizuar sanksionin gjobë nr. 26, datë 07.08.2015 të vendosur nga Grupi i Inspektimit, në masën 1,000,000 (një milion) lekë, për subjektin kabllor “TV Saranda Kabëll”;
11. Pranimin e ankimit administrativ të shoqërisë “Channel One” sh.p.k., duke shfuqizuar sanksionin gjobë nr. 33, datë 08.09.2015 të vendosur nga Grupi i Inspektimit, në masën 1,000,000 (një milion) lekë, subjektin audioviziv privat “TV Channel One”;
12. Pranimin e ankimit administrativ të shoqërisë “Focus Media News” sh.p.k., duke shfuqizuar sanksionin gjobë nr. 30, datë 08.09.2015, në masën 1,000,000 (një milion) lekë për subjektin audioviziv privat “TV News24”;
13. Pranimin e ankimit administrative të shoqërisë “Ora” sh.a., duke shfuqizuar sanksionin gjobë nr. 31, datë 08.09.2015, në masën 1,000,000 (një milion) lekë, për subjektin audioviziv privat “TV Ora News”;
14. Pranimin e ankimit administrativ të shoqërisë “TV Ballkan” sh.a., duke shfuqizuar sanksionin gjobë nr. 34, datë 08.09.2015, në masën 1,000,000 (një milion) lekë, për subjektin audioviziv privat “TV A1 Report”.

Pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës, Këshilli i AMA-s vendosi që për shkak të mungesë së kuorumit të nevojshëm ligjor, të shtyjë vendimmarrjen për çështjet e mëposhtme:

15. Zgjedhjen e Kryetarit dhe Anëtarëve të Këshillit të Ankesave;
16. Rinovimin dhe zëvendësimin e licencës së subjektit audioviziv privat vendor “Tv Scan”;
17. Rinovimin e autorizimit lëshuar për personin fizik Sulejman Leshi, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv kabllor Lushnja”;
18. Dhënien e autorizimit subjektit person fizik Xhezmië Rusta, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Rrasë”;
19. Dhënien e autorizimit subjektit person fizik Guri Meko, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Aral”;
20. Dhënien e autorizimit subjektit person fizik Ladimir Fiska, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Xh&L”;
21. Dhënien e autorizimit subjektit person fizik Eltion Thanasi, për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “APT News”;

Këshilli, gjithashtu, ra dakord të shtyjë shqyrtimin e projektregullores “Mbi procedurat e inspektimit të veprimtarisë së ofruesve të shërbimit mediatik audio dhe ose/ audioviziv” në mbledhjen e ardhshme.

Tiranë, 26 tetor 2015